



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Tiranë, më ____/____/2017

Lënda: Kërkohet mocion me debat, si dhe shqyrtimi dhe miratimi në seancën plenare të Projektrezolutës “Për dënimin e fenomenit të dhunës në familje dhe marrjen e masave urgjente për evidentimin e situatës dhe gjetjen e mekanizmave efikas ligjor për parandalimin e këtij fenomeni”

Drejtuar: ZOTIT GRAMOZ RUÇI
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Baza Ligjore: Nenet 55, 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit

Z. Ruçi,

Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë angazhime të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar diskriminimin, dhunën në familje dhe për të realizuar barazinë gjinore. Në këtë kontekst, parashikimet kushtetuese janë të plota dhe vijimësisht është punuar për zbërthimin e tyre në legjislacionin dytësor. Dokumentat kyçe të politikave kanë vendosur ndër të tjera, si qëllim strategjik forcimin e mekanizmit institucional dhe ligjor nën vizionin “Një shoqëri në të cilën barazia gjinore respektohet dhe vlerësohet, mësohet, mbështetet dhe nxitet, ku dhuna me bazë gjinore e çdo lloj forme nuk tolerohet, por dënohet, ku të prekurit prej saj përkrahen dhe mbrohen dhe ku barazia në mundësi dhe trajtim është realitet për të gjithë, pavarësisht përkatësisë gjinore”. Nga ana tjetër, çështjet e barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës në familje janë në qendër të politikave sociale të vendeve të Bashkimit Europian, me rëndësi të posaçme në procesin e integritit evropian.

Kuvendi, me ligjin nr. 23/2012 dhe me ligjin nr. 11/2013 ka kriminalizuar dhunën në familje si vepër penale (dhuna në familje, rrahja, plagosja, vrasja e pjesëtareve të familjes nga pjesëtarë të tyre ose të afërm të tjerë). Megjithatë mbrojtja civile e garantuar nga ligji nr. 9669/2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, vazhdon të zbatohet, duke konkuruar me ndjekjen penale për veprat e reja penale. Për pasojë, ndryshimet në Kodin Penal nuk e kanë ndryshuar mekanizmin e mbrojtjes nga dhuna në familje, por kanë shërbyer si një masë tjetër plotësuese e viktimave nga dhuna në familje, si dhe për mbrojtjen e të gjithë shoqërisë. Megjithatë, fenomeni i dhunës në familje vijon të njoh rritje dhe kohët e fundit janë vërejtur problematika serioze që kërkojnë ndërhyrje urgjente.

Handwritten notes:
Të Kuvendit
Gjithësesi
dhe 10.10.17
dhe 10.10.17

Nisur nga situata e rënduar e fenomenit të dhunës në familje, si dhe faktit se deri më tani Qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë hap për përmirësimin e situatës dhe gjetjen e mekanizmave efikase për parandalimin e dhunës në familje, në mbështetje të nenit 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit, paraqesim këtë mocion me qëllim zhvillimin e një debati në Kuvend për fenomenin e dhunës në familje. Në përfundim të tij, propozojmë miratimin e një rezolute, sipas tekstit bashkëlidhur kësaj kërkesë për zhvillimin e mocionit. Në mbështetje të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, bashkëlidhur ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi i Shqipërisë të ProjektRezolutës "Për dënimin e fenomenit të dhunës në familje dhe marrjen e masave urgjente për evidentimin e situatës dhe gjetjen e mekanizmave efikas ligjor për parandalimin e këtij fenomeni".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Alban Valshe

Edmond Kolinc

Amr

FINKELEZY ALIBECI

Edmond Spaho Spaho

Julian Basha

Vita Shk

Enver

Salicaj

Salicaj

GRIDA

DUNA

Amr

Derol Bylykbasli

Amr

Imide Todor

Amr²



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË**

PROJEKT

REZOLUTË

Nr. ____/2017

**PËR DËNIMIN E FENOMENIT TË DHUNËS NË FAMILJE DHE MARRJEN E
MASAVE URGJENTE PËR EVIDENTIMIN E SITUATËS DHE GJETJEN E
MEKANIZMAVE EFIKAS LIGJOR PËR PARANDALIMIN E KËTIJ FENOMENI**

Duke konstatuar me shqetësim të madh ekzistencën në rritje të krimit brenda familjes dhe pamundësinë e deritanishme për parandalimin e tij;

Duke vlerësuar se Qeveria dhe pushteti vendor kanë dështuar të marrin masat e duhura dhe të nevojshme, për reduktimin dhe parandalimin e dhunës në familje, si dhe për bashkrendimin e punës midis tyre për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje;

Duke e vlerësuar si një fenomen të rëndë për shoqërinë shqiptare, si dhe duke i konsideruar krimet brenda familjes si akte më shumë se kriminale;

Duke afirmuar të gjithë angazhimin për evidentimin e situatës dhe gjetjen e mekanizmave efikase ligjore për parandalimin e këtij fenomeni;

Duke çmuar se krimet brenda familjes konsiderohen si akte që trondisin jo vetëm familjen përkatëse, por të gjithë shoqërinë shqiptare, dhe si të tilla kërkojnë angazhimin e të gjithë shoqërisë për raportimin dhe parandalimin e tyre;

Duke mbajtur në konsideratë se parandalimi dhe reduktimi i dhunës në familje në të gjitha format e tij, është i ndërlidhur me një sërë faktorësh socialë dhe ekonomikë, që kërkojnë angazhim të gjithanshëm;

Duke qenë të ndërgjegjshëm për vështirësinë që paraqet zgjidhje përfundimtare e kësaj situate, dhe nevojën e një bashkërendimi efikas nga të gjitha strukturat shtetërore dhe shoqëria civile;

KUVENDI I SHQIPËRISË:

1. Dënon fuqimisht aktet e dhunës në familje dhe krimet brenda saj, duke i konsideruar jo vetëm si akte kriminale, por dhe fenomene që cenojnë bazën e shoqërisë dhe kërkon masa të ashpra, duke mbajtur në konsideratë interesin më të mirë të fëmijëve dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes.

2. Angazhohet të krijojë brenda 15 ditëve një Komision të Posacëm për trajtimin e këtij fenomeni dhe ndërmarrjen e të gjitha hapave të nevojshëm për adresimin e kësaj problematike, dhe gjetjen e mekanizmave efikase për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, si dhe propozimin e ndërhyrjeve ligjore të nevojshme që ndihmojnë në përmirësimin e situatës.

3. Mbështet dhe inkurajon të gjithë viktimat e dhunës në familje që të denoncojnë dhunën, si dhe të bashkëpunojnë me organet kompetente për zbatimin e legjislacionin në fuqi, duke i siguruar për mbikëqyrje të fortë parlamentare dhe trajtim të të gjitha rasteve të denoncimeve për dhunën në familje.

4. Vendos krijimin e Nënkomisionit të Përhershëm të Parandalimit dhe Mbrojtjes ndaj Dhunës në Familje, pranë Komisionit përgjegjës për çështjet sociale, i cili do të ketë si objekt të veprimtarisë së tij mbikëqyrjen parlamentare të institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe përmbushjen prej tyre të të gjitha detyrimeve ligjore. Nënkomisioni është i detyruar të informojë seancën plenare cdo 6 muaj mbi rezultatet e punës së institucioneve shtetërore dhe nevojën për marrjen e masave shtesë për parandalimin, reduktimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës në familje.

5. Kërkon nga Qeveria që brenda 60 ditëve nga miratimi i kësaj Rezolute, të paraqesë në Kuvend:

- a) një analizë të plotë ligjore mbi problematikat e evidentuara në praktikë;
- b) të dhënat konkrete mbi fenomenin;
- c) krijimi i një regjistri kombëtar për dhunën në familje;
- d) propozime konkrete për ndryshime ligjore, me fokus të posacëm:

i. përcaktimin në ligj të një strukture të vetme përgjegjëse për koordinimin e veprimtarisë së të gjithë institucioneve shtetërore që janë përgjegjëse për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, si dhe garantimin e mbrojtjes së

viktimave të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të vecantë fëmijëve, grave, të moshurve dhe personave me aftësi të kufizuara.

ii. Ndryshimin e ligjit dhe ashpërsimin e parashikimeve ligjore për heqjen përfundimtare të mundësisë për të përfutur nga amnistia apo nga rrethana të tjera lehtësuese, në të gjitha rastet e gjyqimit apo dënimit për krimet brenda familjes.

iii. përcaktimin e autoritetit përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, pas shkrirjes së Ministrisë së Punës, Cështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta.

iv. rishikimin e masave mbrojtëse ndaj dhunës në familje, duke eliminuar situatën e evidentuar në praktikë, ku dhunuesi dhe viktimat e dhunës, edhe pas vendosjes së masës së mbrojtjes, lejohen të bashkëjetojnë në të njëjtin ambient.

v. forcimin e mekanizmit të mbrojtjes, mbështetjes dhe rehabilitimit të viktimave, me qëllim lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e vijimit të dhunës në familje, duke ofruar plotësimin e të gjitha nevojave për personat e dhunuar në familje, përfshirë asistencë të përshtatshme dhe mjaftueshme financiare, punësim, strehim, si dhe shërbime mjekësore dhe sociale.

vi. rishikimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimës dhe vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme për rastet e rrezikut për jetën, duke mirëpërcaktuar detyrimet e Policisë së Shtetit në këto raste, përcaktimin e personave përgjegjës që marrin përsipër të mbajnë nën kontroll dhunuesin, si dhe aplikimin gjerësisht të mbikëqyrjes elektronike për rastin e dhunuesve brenda familjes.

vii. thjeshtimin e procedurave gjyqësore për shqyrtimin dhe lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, dhe ndjekjen efikase të ekzekutimit të tij, duke parashikuar në çdo rast vijimin e procesit gjyqësor pavarësisht tërheqjes së mëvonshme të viktimës, si dhe ngritjen e një mekanizmi eficient të mbikëqyrjes së veprimtarisë së organeve gjyqësore në proceset gjyqësore të dhunës në familje.

viii. garantimin e mekanizmave rehabilitues për dhunuesin dhe viktimat e dhunës në familje, me fokus të vecantë eliminimin e pasojave të dhunës dhe shmangien e mundësisë së ripërsëritjes së saj në të ardhmen.

6. Duke shprehur shqetësimin serioz për mos ngritjen nga njësitë e qeverisjes vendore të qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, apo për mungesën e koordinimit të punës me ato ekzituese, si dhe mos alokimin e fondeve përkatëse financiare nga ana e Qeverisë për përmbushjen e këtij funksioni të deleguar, kërkon nga Qeveria që të marrë të gjitha masat e nevojshme që kjo përgjegjësi t'i përkasë qeverisë qendrore dhe në Buxhetin e Shtetit të parashikohen fondet e nevojshme financiare për ngritjen dhe financimin e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, duke filluar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2018.

7. Kërkon nga njësitet e qeverisjes vendore angazhimin maksimal për përmbushjen e përgjegjësisë ligjore në kuadër të parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje, si dhe kërkon nga Qeveria të mbikëqyrë realizimin e këtyre përgjegjësisë, duke e konsideruar si shkelje të rëndë të ligjit, mosmarrjen e masave sipas nenit 7 dhe 8 të ligjit nr. 9669/2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

8. Duke vlerësuar lart kontributin e shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve sociale për viktimat dhe dhunuesit, i fton organizatat jofitimprurëse të licencuara në këtë fushë, që të maksimalizojnë përpjekjet për parandalimin, reduktimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, duke ushtruar të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.

9. Duke çmuar se legjislacioni aktual ka dështuar të sigurojë mbrojtjen e nevojshme për viktimat e dhunës në familje, deklaron me vendosmëri se do të hartojë dhe miratojë brenda këtij Sesioni Parlamentar, legjislacionin e nevojshëm për mbrojtjen efektive të viktimave të dhunës në familje dhe ndërtimin e një mekanizmi realist për mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Në këtë rast, duhet të adresohen çështjet e parashikuara në pikën 5 të kësaj Rezolute, si dhe të mbahen në konsideratë problematikat e evidentuara nga institucionet përgjegjëse si më poshtë:

- a)** Rritja e cilësisë së mbrojtjes ndaj të dëmtuarës nga dhuna në familje, ku një rol i posaçëm i takon Policisë së Shtetit dhe prokurorisë. Problematika bazë në këtë drejtim lidhet me rolin e paqartë procedural të Policisë së Shtetit, si rezultat i të cilës, praktika gjyqësore ka qenë e ndryshme. Në një numër të konsiderueshëm gjykatash, Policia e Shtetit si pritëse e parë e viktimave të dhunës në familje, plotëson dokumentacionin dhe i paraqet ato administrativisht në gjykatë, duke mos ndjekur më tej çështjen gjyqësore. Në shumicën dërrmuese të këtyre rasteve, çështjet gjyqësore të transmetuara administrativisht prej Policisë së Shtetit pushohen, sepse e dëmtuara nga dhuna në familje tregon mungesë vullneti për të vijuar, ndërkohë që si paditës nuk është paraqitur Policia e Shtetit.
- b)** Mungesës së një baze solide të të dhënave në sistemin gjyqësor mbi dhunën në familje, që vështirëson identifikimin e rasteve, monitorimin e tyre dhe analizën e të dhënave. Edhe Policia e Shtetit nuk ka të dhëna solide mbi këto çështje sepse për të njëjtat raste, në praktikë është evidentuar se paraqiten kërkesa të vecanta në gjykatë.
- c)** Rritja e efikasitetit të gjykatave në drejtim të kohëzgjatjes së gjykimeve, për shkak se në praktikë evidentohen shkelja në mënyrë sistematike e afateve

procedurale të vendosura nga ligji për shqyrtimin e kërkesave dhe dhënien e vendimeve gjyqësore mbi to.

- d)** Rritja e efikasitetit të gjykatave në drejtim të procedurave të sakta për të shmangur zhvillimin e gjykimit me më shumë se sa një seancë. Në këtë pikë, shfaqen problematika në njoftimin e palëve, në paraqitjen e provave dhe në pranimin e kërkesave për shtyrje të palëve prej gjykatës. Gjykimet mbi dhunën në familje janë të natyrës specifike dhe janë ndërtuar nga ligjvënësi për t'u përfunduar brenda një seance, që nënkupton bashkërendimin e të gjithë aktorëve, që nga Policia e Shtetit e deri tek mbrojtësit për të siguruar adresë të plotë dhe një set të plotë dokumentacioni provues në kohën e paraqitjes së çështjes në gjykatë. Për pasojë, ka nevojë për saktësimin edhe në nivel ligji të këtyre procedurave, si dhe rritjen e efikasitetit të gjykatave në drejtim të zgjidhjes së themelit të çështjeve.
- e)** Ligji nr. 9669 dt 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, ka parashikuar dispozita të shpejta procedurale të gjykimit të këtyre çështjeve për gjykatat e shkallës së parë, ndërsa për gjykatat më të larta jo.

10. Nxiti qeverinë që të rrisë fondet dhe përpjekjet për të luftuar efektivisht dhunën në familje, duke e konsideruar këtë një fenomen që kërkon trajtim prioritar, dhe që duhet të përfshijë një fushatë të gjerë ndërgjegjësimi mbi pasojat e dhunës në familje dhe vecanërisht dënimin e autorëve të këtyre akteve kriminale.

Tiranë, më ____/____/2017

KRYETARI

GRAMOZ RUCI